

Nëse është e nevojshme ju keni të drejtën të përdorni shërbimet e një përkthyesi. Lutemi na informoni për kërkesat për një përkthyes kur caktoni vizitën tuaj. Personeli i kujdesit ndaj shëndetit do të organizojë një përkthyes nga një agjenci përkthimi.

## **Nëse fëmija juaj sëmuret**

### **Urgjencat**

Kontaktoni pavijonin e urgjencës për fëmijët në numrin 0470 58 83 00 nëse fëmija juaj është sëmurë rëndë ose nëse një plagë e rëndë kërkon trajtim të menjëhershëm në spital ose telefononi centralin në numrin 58 80 00. Nëse ju duhet ambulance telefononi 112.

#### **Si të shkoni:**

Pavijoni i urgjencave për fëmijët është në katin e 6-të të Godinës T.

Është më lehtë të shkoni në pavijonin e urgjencave për fëmijët nëpërmjet pavijonit Värendsgatan. Shkoni në drejtim të Spitalit Qendror dhe kaloni përmes parkingut të makinave dhe drejtohuni për nga e djathta ku do të shihni shenjën "Barnakut". Ngjituni në katin e 6-të.

Pavijonin e emergjencave për fëmijët mund të kontaktoni në çdo kohë duke telefonuar: 0470-58 83 00, 58 80 00 Centrali.

Telefononi 112 nëse ju duhet ambulancë.

## **Klinika e Fëmijëve dhe Adoleshentëve, Växjö**

Vizitat e paracaktuara, caktimi i vizitave dhe shërbimet e këshillimit.

Telefoni: 0470-58 84 50

## **Pavijoni mjekësor i Fëmijëve dhe Adoleshentëve, Ljungby**

Telefoni: 0372-58 53 60

Telefonatat e urgjencës (jashtë orarit): 0372-58 50 00

## **Shërbimet këshillimore**

Kontaktoni qendrën e mjekësore për fëmijët për probleme që kanë të bëjnë me foshnjat, ushqimin e fëmijëve dhe probleme të tjera mbi fëmijët e vegjël.

Kontaktoni qendrën tuaj shëndetësore të kujdesit parësor për këshilla në lidhje me kujdesin për fëmijët e sëmurë. Ju mund të telefononi edhe Shërbimin Këshillimor Mjekësor në numrin: 1177 në çdo orë.